## *AKT THEMELIMI*
## *I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR*
## *" MAVEIMPEX "*

Ne baze te ligjit 7512 dt. 10. 8. 1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones private e privatizimit, te ligjit nr. 7638 date 19. 11.1992 "Per shoqerite tregtare", dhe te ligjit nr. 7667 date 28. 1. 1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin tregtar", me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenshkrimin e ketij akti, une, Esat Isuf Tuzi, dtl. 5 tetor 1958, lind e banues ne Shkoder, lagje " Qemal Stafa ", rruga " Lidhja e Prizrenit ", nr. 44, Shkoder, tel. nr. 0224 7872, kam krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar " MAVEIMPEX" Sh. P. K., Shkoder.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " MAVEIMPEX " Sh. P. K. Shkoder, eshte : tregtim me pakice dhe shumice i artikujve te ndryshem industriale dhe ushqimore, import eksport.

SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " MAVEIMPEX" SH.P.K. Shkoder, eshte ne qytetin e Shkodres, ne lagje "Qemal Stafa", rruga "Lidhja e Prizrenit", Shkoder.

KOHEZGJATJA

Jetegjatesia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Maveimpex " Sh. P. K. eshte mbi 10 vjet. Ajo mund te shperndahet me vendim te administratorit te shoqerise, ose te autorizuarit prej tij, kur i autorizuari ka prokure te posaçme per shperndarjen e shoqerise.

( Vijon prapa) ./..

## KAPITALI THEMELOR OSE PJESET

Kapitali themelor i shoqerise " Maveimpex " eshte leke 100.000.

Per te sanksionuar veprimtarine e vet, si dhe maredheniet e punes ne te gjithe fushat e saj, shoqeria do te kete e do te çele librin e saj, qe quhet "Libri i Shoqerise".

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " Maveimpex" do te kete dhe do te mbaje llogarine e saj, duke u mbeshtetur tek leku shqiptar dhe valutat e huaja.

Maredheniet e punes ne shoqeri, do te rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per çeshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes, ato do te rregullohen ne baze te legjislacionit ne fuqi, me vendim te administratorit te shoqerise, ose Asamblese se Ortakeve( n.q.s. do te kete ortake te tjere), gjithmone sipas legjislacionit ne fuqi per kete çeshtje.

Kjo kontrate, pasi u lexue me ze te larte, u firmos nga ortaku i vetem i shoqerise " Maveimpex " Sh. P. K., qe eshte dhe administratori i saj:

Ortaku i vetem

Esat Isuf Tuzi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA NOTERISE SHKODER

Nr. rep 324 Nr. kol

Ne kopjen e arshives u vendos pulla e takses.

AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Ne Dhomen e Noterise Shkoder, dhe para meje noterit Arben Salim Kopliku, sot me daten 28. 2. 2000 (njezet e tete shkurt dymije), te henen, u paraqit personalisht zotni Esat Isuf Tuzi, dtl. 1958, lind e banues ne Shkoder, lagje " Q. Stafa", rruga " Vasil Shanto", nr. 44, Shkoder, e me tel. nr. 0224 7872, i njohur prej meje si i tille, e me zotesi te plota juridike per te vepruar, me kerkese te tij, vertetoj se nenshkrimi i hedhur me siper, eshte vene ne prezencen time:

Noter

Arben Salim Kopliku

***STATUT***
***I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR***
***" MAVEIMPEX "***

NENI 1

EMERTIMI

Ne baze te ligjit 7512 dt. 10. 8. 1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones private e privatizimit", te ligjit nr. 7638 date 19. 11.1992 "Per shoqerite tregtare", dhe te ligjit nr. 7667 date 28. 1. 1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin tregtar", me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenshkrimin e aktit te themelimit, qe i bashkohet ketij statuti: une, Esat Isuf Tuzi, dtl. 5 tetor 1958, lind e banues ne lagjen " Qemal Stafa ", rruga " Lidhja e Prizrenit ", nr. 44, Shkoder, me nr. telef. 0224 7872, kam krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "MAVEIMPEX" Sh. P. K.,

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "MAVEIMPEX", fiton personalitetin juridik nga dita e rregjistrimit te saj ne Gjykaten e Rrethit te Tiranes. Ajo eshte person juridik shqiptar, dhe e zhvillon aktivitetin e vet ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi, dhe aktet e saj themeluese, si ky statut, si dhe kontrata qe i bashkohet dhe perben nje pjese te pandate te tij.

NENI 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " PUKAIMPEX " Sh. P. K. Shkoder, eshte : tregtim me shumice e pakice i artikujve te ndryshem industrial dhe ushqimore, import -eksport;.

NENI 3

SELIA E SHOQERISE.

( vijonprapa)

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " MAVEIMPEX " SH.P.K. Shkoder, eshte ne qytetin e Shkodres, ne lagje " Qemal Stafa ", rruga " Lidhja e Prizrenit ", nr. 44, Shkoder.

Aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet ne qytetin e Shkodres, por ai do te shtrihet ne te gjithe territorin e Repubikes se Shqiperise, si dhe jashte saj. Qendra e shoqerise, qe eshte ne seline e sipertreguar, eshte e rregjistruar ne librin e shoqerise "Maveimpex " sh. p. k.. Kjo shoqeri mund te hape filiale te saj ne rrethe te ndryshme te vendit, apo dhe jashte, duke zbatuar te gjithe legjislacionin ne fuqi te vendeve ku do te hapen.

NENI 4

KOHEZGJATJA

Jetegjatesia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Maveimpex" Sh. P. K. eshte mbi 10 vjet. Ajo mund te shperndahet me vendim te administratorit te shoqerise, ose te autorizuarit prej tij, kur i autorizuari ka prokure te posaçme per shperndarjen e shoqerise, ose shperndarjen e saj e percakton legjislacioni ne fuqi.

NENI 5

KAPITALI THEMELOR

Kapitali themelor i shoqerise " Maveimpex " eshte leke 100.000, qe vjen nga kontributi i vetem i ortakut te vetem z. Esat Isuf Tuzi.

NENI 6

KUOTAT OSE PJESET

Ndryshimi i mases se kapitalit themelor, si per shtimin apo per pakesimin, e tij, behet me vendim me shkrim te administratorit te shoqerise.

Transferimi i tyre behet me akt noterial, ku ka qendren shoqeria. Te tretet i nenshtrohen rregullave te shit-blerjes.

( Vijon prapa) ./..

NENI 7

DREJTIMI I SHOQERISE

Organi me i larte i shoqerise eshte ortaku i vetem, qe ne rastin konkret eshte z. Esat Isuf Tuzi.

NENI 8

ADMINISTRIMI

Shoqeria do te administrohet nga nje person si administrator i vetem i saj, qe eshte ortaku i vetem i kesaj shoqerie.

Te gjithe vendimet e ortakut te vetem ( administratorit ) do te hidhen ne proces-verbale nga nje person i caktuar nga ky ortak, proces-verbale te cilat duhet te nenshkruhen nga ortaku i vetem i saj.

NENI 9

FUQITE E ORTAKUT TE VETEM (ADMINISTRATORIT)

Organi me i larte i shoqerise eshte ortaku ivetem, ose kur merren dhe ortake te tjere, asamblea e ortakeve. Organi administrativ ka kompetenca te gjera, qe perfshin te gjithe veprimtarine e zakonshme dhe te jashtezakonshme te shoqerise, si dhe gjithçka qe parashihohet ne ligj.

Organi administrativ ka keto kompetenca:

- Te marre pjese ne ankande.
- Te perpiloje kontrata dhe çdo akt tjeter juridik , te çdo lloji qofshin, qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise.
- Te perfaqsoje shoqerine ne te gjithe strukturat shoqerore dhe gjyqsore, ne te gjithe shkallet e ne te gjithe llojet, duke mbrojtur interesat e shoqerise.
- Te emeroje drejtor administrativ dhe nepunes te rangjeve te ndryshme.

( Vijon prapa) ./..

- Mund te shese kuotat e veta te treteve teresisht apo pjeserisht, duke i dhene te drejten e parablerjes ortakeve te tjere, n.q.s. mund te shtohen me miratimin e asamblese se ortakeve.

- Te themeloje dhe te ndryshoje servitytet, apo te drejtat e tjera reale, te hape llogari rrjedhese ne Bankat e Shqiperise, apo dhe jashte saj.

- Te ndermarre reciprocitete financiare dhe hipotekuese, te marre pjese ne sipermarrje te tjera financiare te te gjithe llojeve.

- Te bleje, te kembeje e te tjetersoje pasuri te ndryshme qe i sherbejne shoqerise.

- Te marre ne pune dhe persona te tjere si specialiste etj., gjithmone me kontrate pune.

- Te marre pjese, n.q.s. eshte e nevojshme, ne procedurat e falimentimit.

Ky percaktim eshte rregull jo taksativ dhe nuk e kufizon fuqine e organit administrativ (ortakut te vetem).

NENI 10

PERFAQSIMI

Perfaqsimi i shoqerise perballe te treteve eshte e drejte dhe detyre e administratorit te saj, qe eshte dhe ortaku i vetem i saj.

Administratori eshte pergjegjes para shoqerise dhe te treteve si per shkeljet ligjore, shkeljet e statutit, ose per fajet e kryera nga ia gjate administrimit te shoqerise.

Neni 11

Per rastet kur e kerkon ligja, dhe kur e shikon te domosdoshme shoqeria, kontrolli i saj do te kryhet nga nje ekspert kontabel, i ngarkuar per kete qellim.

Eksperti merret ne pune nga administratori i shoqerise, ose nga i

(Vijon prapa) ./..

NOTER SHKODER



autorizuari prej tij.

NENI 12

Te gjithe te punesuarit ne kete shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e shoqerise gjate dhe ne rast se largohen nga puna.

NENI 13

SHPERBERJA E SHOQERISE

Shperberja e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " MAVEIMPEX " sh.p.k. mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo shkaku, si per humbje te kapitalit te shoqerise, pamundesi veprimtarie, me vendim te adminisratorit te shoqerise, apo kur e parashikon ligja.

NENI 14

Me shperberjen e shoqerise caktohen nje ose disa likuidatore, duke ju caktuar detyra konkrete, ne radhe te pare per likuidimin e personave te trete, duke percakuar dhe burimet e likuidimit.

NENI 15

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet plotesimeve qe do te beje administratori i shoqerise.

NENI 16

Ky statut u firmos rregullisht nga ortaku i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " MAVEIMPEX " Sh. p. k.. Shkoder.

OTRAKU I VETEM

Esat Isuf Tuzi

( vijon prapa )